

VENDIM
Nr. 6, datë 10.1.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, germa “c” dhe nenit 83, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 8; nenit 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “f” dhe nenin 10, pikat 1 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ERE, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/5 prot., datë 13.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën nr. 3051 prot., datë 12.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 810 prot., datë 12.12.2019, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”, i ndryshuar; ligjit nr. 7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen plotësuar nga shoqëritë tregtare”, regjistruar si person juridik shqiptar, me vendimin e Gjykatës së Tiranës, nr. 674/1 akti, datë 5.7.1993 dhe mban numrin e identifikimit (NUIS) J61820031J.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: import–eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, gazit natyror etj.

- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezulton si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “e” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor). Plotësuar.

Germa “d” plotësuar pjesërisht. Shoqëria GSA sh.p.k., ka deklaruar se do të përdorë rrjetin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline (TAP). Shoqëria ka paraqitur në ERE statutin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. (vërtetim i njësisë me origjinalin, me nr. rep. 2945, datë 10.12.2019) dhe mbetet të depozitojë në ERE aktin e themelimit dhe certifikatën e regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Mungon germa “e” (ii). Subjekti “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE Pasqyrat financiare të audituara, për vitet 2017 dhe 2018 nga të cilat rezulton një bilanc pozitiv. Do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE edhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016.

Mungon germa “e” (vi). Planin e Biznesit. Do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE Planin e Biznesit.

Mungon germa “e” (vii). Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore ai duhet të informojë ERE për këtë synim dhe të japë një garanci të

performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi. Do t'i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Neni 9, pika 2 (i), (ii), (iii). Subjekti ka bërë përshkrimin e sasisë mesatare të gazit natyror të parashikuar për të livruar, garancinë mbi cilësinë e gazit, si dhe dokumentuar kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit, duke plotësuar kërkesat e kësaj dispozite.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti